



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.230/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, dhe koalicionit AAK&PSD, me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi prej 2,700.00 (dymijë e shtatëqind) euro, për shkak të vendosjes së posterit në hapësirë publike, të cilën shumë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 04.10.2019, në Rr."Luan Haradinaj", në afërsi të obeliskut New Born, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore, nga ana e monitoruesve të KDI-së, është parë një poster i cili i takon koalicionit AAK&PSD, i vendosur në hapësirë publike, përkatësisht në shkallët që ngjisin për në pllantonë e pallatit të rinisë, veprim ky i cili sipas tyre bie në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së. Paraqitësi i ankesës si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një fotografi të printuar, në cilësi të provës materiale.

PZAP, më datë 05.10.2019, konform nenit 7 par.1 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e njoftoi koalicionin AAK&PSD, për ankesën e paraqitur, dhe i dha kohë të përgjigjet deri më datë 06.10.2019 në ora 09:00, mirëpo deri në këtë kohë, nuk mori ndonjë përgjigje nga ana e tyre.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotoja e ofruar si provë nga paraqitësi i ankesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se nga ana e koalicionit AAK&PSD, është bërë vendosja e posterit të kandidatit për deputet nga radhët e tyre, në hapësirë publike,.

Ky veprim është i sanksionuar me dispozitën ligjore të LZP-së, përkatësisht neni 33 par.1, pika b) e cila dispozitë përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakatave dhe posterave, vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut etj*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se subjekti politik kanë qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, sepse ka marr pjesë në zgjedhjet e mëhershme;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se subjektet politike të koalicionit AAK&PSD, nuk marrin pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, po ashtu si rrethanë tjetër, PZAP-i mori edhe faktin që këtij subjekti, i'a dha mundësinë për t'u përgjigjur në ankesë dhe ta evitojnë shkeljen e bërë, mirëpo nga ana e këtij subjekti politik nuk u paraqit ndonjë përgjigje lidhur me pretendimet e palës ankuese dhe as ndonjë dëshmi për evitimin e shkeljes, veprim ky i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Me anë të këtij vendimi respektivisht gjobës së shqiptuar paneli synon të ndikon te subjekti politik që në të ardhmen ky subjekt mos t'i përsërit veprimet e njëjta apo veprime tjera të cilat bien ndesh me ligjin.

Paneli në kuptim të nenit 118 par.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.230/2019 më datën 06.10.2019

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së